



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Pristina, nr./dt. Mijeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Më, 12.01.2018

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 63 paragrafi 4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 8 paragrafi 1 germa e) të Rregullës nr.01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, në mbledhjen e mbajtur me datë 12.01.2018, merr këtë:

V E N D I M

Mbi çregjistrimin e Partisë Politike- Partia Konservatore e Kosovës-PK

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës, që nga regjistri i partive politike të çregjistrohet partia politike "Partia Konservatore e Kosovës-PK", për mos përmbushjen e obligimeve që dalin nga neni 15 i Rregullës 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.
- II. Partia Politike, "Partia Konservatore e Kosovës-PK", nuk i ka përmbushur obligimet në afatin e shtuar prej dyzet e pesë (45) ditësh nga dita e pezullimit.
- III. Kryetari dhe organet drejtuese të partisë politike "Partia Konservatore e Kosovës-PK", edhe pas marrjes së vendimit për çregjistrim nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vazhdojnë të jenë përgjegjës për të gjitha të drejtat dhe obligimet e krijuara gjatë periudhës së të qenurit aktiv.
- IV. Obligohet Zyra që ta fshij nga Regjistri, Partinë Politike, "Partia Konservatore e Kosovës-PK".
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

A r s y e t i m

Përfaqësuesi i partisë politike, "Partia Konservatore e Kosovës-PK", i njoftuar me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për afatin e dhënë shtesë, nuk ka dorëzuar ndonjë njoftim dhe as dokumentacion që ka mbajtur kuvend zgjedhor, sipas nenit 15 të Rregullës nr 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike. Pas rekomandimit të Zyrës, kjo parti politike është pezulluar me Vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me datë 23.11.2017, në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 germa a)

dhe i është dhënë afat shtesë sipas nenit 6 paragrafi 1 germa aa) të Rregullës nr.01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.

Këshila juridike: Kryetari i Partisë Politike, , "Partia Konservatore e Kosovës-PK", z. Munir Basha, ka të drejtë ankese në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP, brenda 24 orëve nga marrja e Vendimit .

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



Republika e Kosovës
Prishtinë
Valdete Daka